



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA
DEPARTAMENTI I GJUHËVE SLLAVE DHE
BALLKANIKE



PROGRAMI I LËNDËS
Gramatikë e aplikuar e Gjuhës B (2)

Ngarkesa: 4 kredite; 20 orë leksione + 20 orë seminare;
Viti / Semestri : Viti I, semestri II
Lloji i lëndës: Lëndë e detyrueshme
Programi i studimit: “Bachelor” në Përkthim dhe Interpretim ruse”
Kodi i lëndës: Kodi i etikës i UT-së (nenet 4, 6, 7, 9)

PËRMBLEDHJE DHE REZULTATET E TË NXËNIT:

Objektivat e përgjithshme lëndore: Lënda "Gramatika e aplikuar e gjuhës B (2)" është vazhdim i modulit të parë të lëndës Gramatikë e Aplikuar (1), e cila është parashikuar si domosdoshmëri për mësimin e gjuhës ruse, për shkak të specifikës që paraqet vetë gramatika e kësaj gjuhe, vështirësive të përvetësimit të saj vetëm në orët e gjuhës praktike. Në këtë modul trajtohen kryesisht kuptimet gramatikore të rasave, përdorimi i tyre me parafjalë, gjë e cila i jep mundësi studentit që nëpërmjet ushtrimeve të ndryshme gramatikore, të arrijë të kuptojë ndërtimin e një teksti, të mund të krijojë fjali si të thjeshta ashtu edhe të përbëra.

Objektivat specifike lëndore:

1. Ushtrojë kompetencën ligjërimore gramatikore saktë dhe lirshëm. Nëpërmjet ushtrimeve të përsëritura dhe pjesëmarrjes së tij të vazhdueshme, ai duhet të ngulisë, të përthithë e përvetësojë rregullat dhe aplikimin e tyre në ligjërime.
2. Analizojë dhe të formojë një gjykim personal, të arsyetojë mbi gabimet e bëra duke i vlerësuar dhe korrigjuar nga vetë ai.

Rezultatet e pritshme.:

1. Përdorë saktë format gramatikore të emrit, përshtatjen e tij me mbiemrin, përemrin. Zgjedhimin e foljeve, përdorimin e ndajfoljes. Rasat me folje pavetore. Parafjalët e ndryshme në përshtatje me rasat e emrit në bazë të kuptimit të tyre gramatikor.
2. Aftësohet jo vetëm për të përdorur saktë format gramatikore si në ligjërimin e folur ashtu edhe në të shkruar, por për të pasur një nuhatje gjuhësore pa qenë nevoja e sjelljes ndërmend të një rregulli të caktuar, duke u mbështetur në aftësitë krijuara gjatë ushtrimit të kompetencës gramatikore praktike.